



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2021:167019

Datë: 24.07.2023

Numri i dokumentit: 04514328

**C.nr.1531/21**

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil gjyqtarja Edije Sezairi me praktikanten gjyqësore N.D. në çështje juridike kontestimore të paditësit B.M. nga Mamusha të cilin me autorizim e përfaqëson av. N.E. nga Prizreni, kundër të paditurit 'S.C.LLC' me seli në Mamushë, të cilin e përfaqëson Y.M. nga Mamusha, me objekt të kontestit padi për kompensim dhe vlerë të kontestit 100 euro, jashtë seancës gjyqësore me datën 26.07.2023, morri këtë:

**A K T V E N D I M**

**KONSIDEROHET e tërhequr** padia e paditësit B.M. nga Mamusha të cilin me autorizim e përfaqëson av. N.E. nga Prizreni, kundër të paditurit 'S.C.LLC' me seli në Mamushë, të cilin e përfaqëson Y.M. nga Mamusha, me objekt të kontestit padi për kompensim dhe vlerë të kontestit 100 euro.

**A r s y e t i m**

Pranë kësaj gjykate paditësit B.M. nga Mamusha përmes të autorizuarit të tij av. N.E. nga Prizreni, ka paraqitur padi me datën 28.07.2021 kundër të paditurit 'S.C.LLC' me seli në Mamushë, të cilin e përfaqëson Y.M. nga Mamusha, me objekt të kontestit padi për kompensim dhe vlerë të kontestit 100 euro.

Gjykata me aktvendim C.nr.1531/21 të datës 12.08.2021 e ka ftuar paditësin B.M. nga Mamusha të cilin me autorizim e përfaqëson av. N.E. nga Prizreni që ta paguaj taksën gjyqësore për vlerën e paraparë të padisë, i njëjti nuk e ka përmbushur këtë obligim.

Nga fletëdërgesa e gjykatës konstatohet se paditësi përkatësisht i autorizuari i tij e ka pranuar aktvendimin me datën 16.08.2021, dhe që gjykatës nuk i ka sjell dëshmi mbi pagesën e taksës apo dëshmi për lirimin nga taksa.

Në bazë të nenit 253 para.4 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), '*paditësi ka për detyrë që padisë t'ia bashkangjesë dhe vërtetimin mbi taksën e paguar gjyqësore*', ndërsa sipas paragrafit 5 të po këtij neni '*nëse paditësi edhe pas vërejtjes së dërguar nga ana e gjykatës nuk*

*e paguam taksën gjyqësore, ndërsa nuk ekzistojnë kushtet për lirimin e tij nga pagesa e taksës gjyqësore, do të konsiderohet se padia është tërhequr''.*

Nga se u tha më lartë, e konform dispozitave ligjore të paraparë me nenin 253 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**  
**C.nr.1531/21 date 26.07.2023**

**Praktikantja gjyqësore**  
**Nimet Demiri**

**Gjyqtarja**  
**Edije Sezairi**

**KËSHILLË JURIDIKE:** kundër këtij aktvendim pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh, pas marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.